

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10465, DATË 29.9.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është që, nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet i mundur zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e shërbimit veterinar, duke mundësuar kalimin e kompetencave e të funksioneve të shërbimit veterinar të vetëqeverisjes vendore në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR, pasi, me miratimin e ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore nuk i kanë më këto funksione. Për këtë qëllim, ky projektligj ka për objektiv të forcojë masat parandaluese e të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve nëpërmjet forcimit të strukturave të kontrollit dhe shërbimit, për të garantuar mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj plotëson kuadrin ligjor në lidhje me kalimin e kompetencave dhe të funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR dhe vakuume ligjore të ndryshme, duke synuar përmirësime në kuadrin ligjor në mbështetje të punës së shërbimit veterinar në arritjen e objektivave dhe standardeve të BE-së, të përcaktuara në politikat dhe strategjitë e qeverisë në tërësi dhe të MBZHR-së në veçanti.

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të akteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave në vitin 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Incidentet e ndodhura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, të cilat kanë lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike apo edhe të lëndëve mbetëse të

dëmshme, të cilat gjenden në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangë në një nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande është i shkëputur, për shkak të fragmentizimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Për këtë qëllim, ky projektligj parashikon unifikimin e zinxhirit të komandës në linjë vertikale, duke bërë të mundur kryerjen e funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit vendor nga shërbimi veterinar shtetëror rajonal. Po kështu, plotësohet edhe rekomandimi i vazhdueshëm i dhënë në raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe të misionit të OIE-së në vitin 2014 në Shqipëri për vlerësimin e kapaciteteve dhe të strukturave të shërbimit veterinar, i cili rekomandoi se “është i një rëndësie kritike rishikimi i roleve dhe përgjegjësi të Ministrisë së Brendshme, veterinerëve të bashkive, duke konsideruar shumë të rëndësishëm transferimin e tyre në Shërbimin Veterinar Shtetëror, pasi sigurohet kapaciteti teknik dhe menaxhues i Shërbimit Veterinar Shtetëror”.

Projektligji parashikon forcimin e kontrollit të therjes së kafshëve, nëpërmjet kalimit të kontrollit shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes nga veterineri zyrtar i shërbimit veterinar rajonal, duke eliminuar, në këtë mënyrë, shkëputjen e hallkës së kontrollit të shëndetit të kafshës para dhe pas therjes. Lëvizja e kafshëve të gjalla dhe tregtimi i tyre në tregun e kafshëve të gjalla, e cila është njësi epidemiologjike, janë burim kryesor i transmetimit dhe përhapjes së sëmundjeve nëse nuk përfshihen në kontrollin brenda standardeve të zinxhirit të kontrollit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Për këtë qëllim, projektligji parashikon që edhe kontrolli i tregjeve të kafshëve të gjalla të përfshihet në detyrat e veterinerit zyrtar të shërbimit veterinar rajonal. Për herë të parë, në zbatim të rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit Evropian dhe të projektit të BE-së PAZA, projektligji parashikon zbatimin e masave për biosigurinë në ferma, me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve të kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambienti tjetër dhe mjetet e transportit”. Që nga viti 2016, kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve iu delegua klinikave veterinare private të kontraktuara. Nga vlerësimi i punës së tyre për punën e kryer në lidhje me detyrat e deleguara, rezultoi se kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve nuk garantohej sipas standardeve dhe strategjive në fuqi në një masë të konsiderueshme. Konstatim të njëjtë kanë edhe ekspertët e projektit PAZA. Për këtë qëllim, projektligji parashikon kryerjen e shërbimeve në shëndetin e kafshëve nga shërbimi veterinar rajonal. Veterinerët zyrtarë, që do të kryejnë këto funksione, do të jenë më afër fermerit në çdo njësi administrative, përgjegjës për ofrimin e shërbimit në zbatim të strategjive për sëmundje të ndryshme, mbajtjen nën kontroll të situatës epizootike si dhe të lëvizjes së kafshëve në njësinë ku ata janë përgjegjës. Projektligji parashikon që shërbimi veterinar rajonal të ketë edhe funksione kontrolli, ndër të cilat përfshihet edhe monitorimi i zbatimit të

shërbimeve. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të shërbimit veterinar shtetëror është parashikuar të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Projektligji, për herë të parë, parashikon që institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, në raste të konstatuara ose të dyshimta për mospërputhje me standardet e sigurtisë ushqimore dhe që shkakun mund të jetë kafsha e gjallë, për të vlerësuar shkakun e origjinës, mund të kryejë gjurmim në fermën e kafshëve të gjalla. Në këtë rast, shërbimi veterinar rajonal mbështet institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Me qëllim kalimin e plotë të kompetencave për kontroll dhe vendimmarrje në PIK për ngarkesat me kafshë të gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, që importohen, eksportohen ose tarrizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, është riformuluar neni përkatës për t'ia kaluar këtë kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i cili është autoriteti përgjegjës për pikat e inspektimit kufitar.

Projektligji përmirëson dispozitat në lidhje me Qendrën Kombëtare të Referencës, instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurtisë ushqimore dhe veterinarisë, duke i dhënë edhe vlerësimin shkencor. Nga ana tjetër, instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurtisë ushqimore dhe veterinarisë duhet të përgatitet për hyrjen në rrjetin evropian të laboratorëve të referencës me hapjen e negociatave me BE-në.

Në kuadër të derregullimit, projektligji përmirëson procedurat e regjistrimit në Republikën e Shqipërisë të produkteve mjekësore veterinare, duke reduktuar kohën e regjistrimit nga 210 ditë në 100 ditë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në këtë projektligj ka 50 nene, të cilat kanë përmbajtje si më poshtë:

- Në nenin 1 propozohet që kudo në ligj emërtimet “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” dhe “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë” të zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministri”, “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë” dhe “Instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë”. Gjithashtu, neni synon dhe disa ndryshime të tjera të emërtimeve përgjatë neneve dhe shtimin e fjalëve “informon strukturën përgjegjëse për veterinarinë e cila...”, në pikën 2, të nenit 25.
- Në nenin 2 propozohen ndryshime në nenin 1, të ligjit, duke shtuar në pikën 4, pas fjalës “... shtazore ...” fjalët “... jo për konsum njerëzor ...” dhe shtimin e pikës 12, që përcakton rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme të kafshët ose njerëzit, duke bërë të mundur vendosjen e masave urgjente që duhen marrë në rast të shpërthimit të një sëmundjeje.
- Në nenin 3 propozohen ndryshime në nenin 2, të ligjit, duke shtuar pikën 4, si objekt për arritjen e qëllimit të shtuar në nenin 1, dhe fjalët “Kafshët me pronar ose jo, kafshët e egra, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore jo për konsum human, subjektet, mjetet e transportit, pajisjet, si dhe çdo material, i cili ndikon ose është i prirur të ndikojë në përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme të kafshëve”.
- Në nenin 4 propozohen ndryshime në nenin 3, të ligjit.
- Në nenin 5 propozohen ndryshime në 4, të ligjit, që përcakton se autoriteti kompetent është struktura e shërbimit veterinar shtetëror përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së shërbimit veterinar në kryerjen e kontrollit zyrtar dhe të aktiviteteve të tjera veterinare. Kjo dispozitë e vendos autoritetin kompetent në varësi të ministrit dhe përcakton që në ministri organizohet një strukturë përgjegjëse për veterinarinë, e cila mbulon shërbimin veterinar (SPV). Në vijim, në këtë nen janë shtuar disa përkufizime.
- Në nenin 6 propozohet të ndryshohet neni 6, i ligjit, “Identifikimi i kafshëve të prodhimit”, pasi të kafshët e prodhimit, që i nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm, nuk ishin përfshirë kafshët njëthundrake (kuajt, mushkat gomerët). Identifikimi i këtyre kafshëve është shumë i rëndësishëm, pasi njëthundrakët preken nga disa sëmundje zoonotike (që trasmetohen edhe te njeriu), si dhe sëmundje të tjera infektive. Identifikimi i tyre do të ndihmojë që në rastet e shfaqjes së një sëmundjeje të njëthundrakëve të mund të gjurmohet ferma e origjinës dhe fermat ku mund të ketë lëvizur kjo kafshë. Në këtë mënyrë mund të parandalohen, të zbulohen dhe të kontrollohen sëmundjet infektive të njëthundrakëve. Në kushtet e mbarshimit në ferma të vogla ato mund të bëhen burim i përhapjes së sëmundjes nga një fermë në tjetrën edhe sëmundjeve që prekin lloje të tjera të kafshëve. Gjithashtu, identifikimi i kafshëve njëthundrake mundëson hartimin e programeve të monitorimit të sëmundjeve të tyre. Aktualisht, është e miratuar rregullorja për identifikimin e kafshëve

njëthundrake, e cila ka përafruar rregulloren përkatëse të BE-së. Identifikimi dhe monitorimi i sëmundjeve infektive të njëthunrakëve janë dy pikat kyç për të filluar plotësimin e kriterëve për eksportin e njëthundrakëve në vendet e Bashkimit Evropian, një nga prioritetet e ministrisë së bujqësisë, me interes për fermerët dhe ekonominë e vendit. Ndryshimi i propozuar në pikën 3, të nenit 6, në përputhje edhe me pikën 1, të këtij neni, i japin ministrit kompetencën për të urdhëruar identifikimin e detyrueshtëm të llojeve të tjera të kafshëve, për të parandaluar, zbuluar dhe kontrolluar sëmundje infektive.

- Në nenin 7 propozohen ndryshime në nenin 7, të ligjit, duke ndryshuar pikën 3, të këtij neni, që i jep ministrit përgjegjës për veterinarinë autoritetin për përcaktimin e tarifave për funksionimin e sistemit të IR-së. Ndërkohë, tarifat e funksionimit të sistemit IR përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për fushën e veterinarisë.
- Në nenin 8 propozohen ndryshime në nenin 9, të ligjit, ku, me qëllimin human për të mbrojtur jetën e kafshëve, të cilat, si pasojë e veprimeve të papërgjegjshme të pronarëve të tyre lëvizin të paidentifikuara nga vendorigjina, por, njëkohësisht, për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe njerëzve nga përhapja e sëmundjeve të mundshme infektive dhe zoonotike që mund të kenë prekur këto kafshë, ato futen në kushte karantinore në karantinën shtetërore ose në vendin e destinacionit, jo më pak se 21 ditë, për të kryer ekzaminimet e nevojshme veterinare. Shpenzimet për ekzaminimet dhe ditët e qëndrimit në karantinë i ngarkohen pronarit të kafshëve. Ky ndryshim ligjor ul dëmin financiar që pëson pronari i kafshëve si dhe koston financiare për gruposjen e karkasave të kafshëve që do të eliminohen. Gjithashtu, në këtë nen janë parashikuar eliminimi i kafshëve në rastin kur kafshët kalojnë ilegalisht kufirin, kur pronarët refuzojnë të mbulojnë koston për qëndrimin e kafshëve në karantinë, si dhe kur kafshët janë të sëmura me sëmundje infektive ose zoonotike dhe eliminimi i tyre është i detyrueshëm.
- Në nenin 9 propozohen ndryshime në nenin 12, të ligjit, ku fjala “qenve” propozohet të bëhet “kafshët e shoqërimit”. Kjo do të mundësojë që të përfshihen në identifikim edhe llojet e tjera të kafshëve të shoqërimit (psh. macet, brejtësit, lepujt, reptilët, etj.) të cilët shoqërojnë pronarët e tyre dhe mbahen në ambientet shtëpiake.
- Në nenin 10 propozohet ndryshim në nenin 11, të ligjit, në të cilin pika 1 ndryshohet me “1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen dhe regjistrohen, sipas sistemit kombëtar IR”, dhe shfuqizohet pika 4.
- Në nenin 11 propozohet ndryshimi në nenin 14, të ligjit, ku përcaktohet se shërbimi shtetëror veterinar (autoriteti kompetent) plotëson listën e sëmundjeve me sëmundje të reja, bazuar në prioritetet kombëtare.
- Në nenin 12 propozohen ndryshime në nenin 15, të ligjit, ku shtohet pika “q”, që rregullon, krahas masave të përgjithshme profilaktike, edhe masa shitesë të kontrollit të sëmundjeve, të cilat merren bazuar në rrethanat epidemiologjike, llojin e fermave dhe stabilimenteve, vendndodhjet,

prodhimin, llojet dhe kategoritë e kafshëve të përfshira si dhe kushtet ekonomike ose sociale. Këto masa shtesë për kontrollin e sëmundjes miratohen me urdhër të ministrit.

- Në nenin 13 propozohet ndryshimi në nenin 16, të ligjit, ku përcaktohet që me urdhër të ministrit miratohen masat e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve dhe kushtet e shëndetit të tyre, embrioneve, materialit biologjik, produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, që rregullojnë lëvizjen, tregtinë në vend dhe importin e tyre dhe po ashtu ministri miraton edhe programet vjetore të profilaksisë veterinarë shtetërore, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve me pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend, të përgatitura nga SPV-ja.
- Në nenin 14 propozohet ndryshimi në nenin 20, të ligjit, dhe përcaktohet që veterineri zyrtar merr kampionet dhe i dërgon në laboratorin veterinar, të përcaktuar për sëmundjen që dyshohet, dhe lajmëron në sistemin e informacionit të epidemiologjisë veterinarë.
- Në nenin 15 propozohet që pas nenit 20, të ligjit, shtohet neni 20/1, në të cilin përcaktohen masat paraprake profilaktike në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive. Kjo mundëson që shërbimi veterinar të ndërmarë paraprakisht, përpara konfirmimit të një sëmundjeje infektive, masa të mbështetura në ligj, për kontrollin dhe parandalimin e përhapjen e sëmundjes infektive të mundshme.
- Në nenin 16 propozohet që në nenin 21, të ligjit, të ndryshohet pika 1, sipas së cilës, kur ka dyshime, autoriteti kompetent njofton SPV-në, dhe pika 7, duke përcaktuar që ministri miraton rregulloret përkatëse për masat që duhet të zbatohen për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, sipas situatës në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, dhe jo një rregullore, siç është aktualisht.
- Në nenin 17 propozohet ndryshimi në nenin 39, të ligjit. Kjo dispozitë parashikon një sërë masash që merren dhe komunikimet ndërmjet institucioneve. Kostot mbulohen nga pronari ose personi përgjegjës, duke mos krijuar efekte financiare për buxhetin e shtetit.
- Në nenin 18 propozohet që në nenin 41 fjalët "... propozimin e autoritetit kompetent ..." të zëvendësohen me "... udhëzim ...".
- Në nenin 19 propozohet që fjalët "... autoriteti kompetent ..." të zëvendësohen me "... nga struktura përgjegjëse për veterinarinë në ministri dhe autoriteti kompetent në vendin e origjinës ...".
- Në nenin 20 propozohen një zëvendësim në nenin 43 dhe ndryshimi në pikën 3, duke dhënë kompetencë për ministrin, që, në përputhje me Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit dhe të OIE-së, të miratojë urdhrin për shfuqizimin e masave veterinarë për sëmundjet infektive.
- Në nenin 21 ndryshohet pika 45, e ligjit, duke bërë një ndryshim dhe një zëvendësim.
- Në nenin 22 propozohet ndryshimi i nenit 48, të ligjit, duke përcaktuar autoritetin kompetent për të marrë masa për eliminimin e kafshëve të sëmura,

të dyshuara, dhe të bëhet asgjësimi i kadavrave, produkteve të kafshëve, produkteve embrionale, lëndëve të papërpunuara dhe të pajisjeve e mjeteve në një vatër të sëmundjes, që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve.

- Në nenin 23 propozohen ndryshime në nenin 51, të ligjit, në të cilin shtohen detyrat për pronarët ose kujdestarët e kafshëve të prodhimit lidhur me masat e biosigurisë në fermë, sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve, llojit të mbarështimit, si dhe parashikohet miratimi i rregullores nga ministri për masat e biosigurisë në fermë. Biosiguria në fermë është një masë parandaluese shumë e rëndësishme dhe e detyrueshme në vendet e BE-së, për parandalimin e futjes ose të përhapjes së sëmundjeve infektive, duke bërë të mundur edhe minimizimin e dëmtimeve në kafshë dhe humbjet financiare të fermerëve e buxhetit të shtetit për veterinarinë. Gjithashtu, është përcaktuar që ministri miraton rregullat për masat e biosigurisë që zbatohen në fermë.
- Në nenin 24 propozohen ndryshime në nenin 54, të ligjit, pasi, me miratimin e ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë më struktura veterinare. Zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e shërbimit veterinar mundëson kalimin e kompetencave dhe të funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal për në strukturën e shërbimit veterinar. Në këtë nen përcaktohet bashkëpunimi i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar lidhur me zbatimin e masave profilaktike, funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe kullotave, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, kontrollin e qenve dhe maceve të rrugës, kontrollin në ambientet publike për vendosjen e maskës mbrojtëse të kafshët agresive të shoqërimit dhe përcaktohet vendgroposja dhe eliminimi i kadavrave të kafshëve, rrethimi dhe ruajtja e pikave të grumbullimit të mbetjeve. Këto detyra përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Në nenin 25 propozohet ndryshimi i nenit 61, ku përcaktohen subjektet, që merren me organizmin e ekspozitave, të kopshteve zoologjike shëtitëse, me transportin e kafshëve që udhëtojnë me trupat e cirkut, me organizimin e panaireve e të shitjeve të organizuara të kafshëve, jashtë mjediseve të stallave e stabilimenteve, të cilat duhet të njoftojnë, paraprakisht, me shkrim shërbimin veterinar shtetëror për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë. Gjithashtu, autoriteti kompetent miraton ose refuzon kërkesën për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë nen.
- Në nenin 26 propozohet ndryshimi i pikës 3, të nenit 62, pasi me ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj nuk do të ketë më struktura veterinare në njësitë e qeverisjes vendore, ndaj përcaktohet detyrimi i veterinerit zyrtar të urdhërojë eliminimin e detyrueshëm, në vend, për kafshët me dëmtime të rënda, dhe njoftimi i autoritetit kompetent dhe i njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Në nenin 27 propozohen ndryshime në nenin 63, nëpërmjet të cilave sanksionohet që personi fizik apo juridik, i cili grumbullon, tregton apo

përpunon ose jo lëkurë kafshësh, vërteton dhe dokumenton origjinën e lëkurëve të blera nëpërmjet certifikatës veterinare të origjinës. Dokumentacioni mbahet sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit.

- Në nenin 28 propozohet që pas nenit 64 të shtohet neni 64/1, ku përcaktohen rregullat për lëvizjen e kafshëve të egra tokësore kur lëvizin nga një vendbanim në Shqipëri në një vendbanim tjetër në Shqipëri ose në një shtet tjetër. Gjithashtu, në këtë nen përcaktohet që kafshët e egra gjatë lëvizjes të shoqërohen me një certifikatë shëndetësore ose dokumente të tjera veterinare, të përcaktuara nga autoriteti kompetent, dhe ku certifikimi i shëndetit të kafshëve është i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e shëndetit të kafshëve për lëvizjet e parashikuara. Përcaktim tjetër në këtë nen është dhe miratimi me urdhër të ministrit të rregullave të hollësishme për lëvizjen e kafshëve të egra. Në ligj, aktualisht, nuk ka asnjë referencë ligjore për rregullat e lëvizjes së kafshëve të egra tokësore. Ndryshimet e propozuara e plotësojnë këtë vakum ligjor.
- Në nenin 29 propozohet ndryshimi i pikës 3, të nenit 81, ku fjalët “shërbimi veterinar rajonal” zëvendësohen me “autoriteti kompetent”. Kjo dispozitë rrjedh nga fakti se organet e vetëqeverisjes vendore nuk kanë shërbim veterinar.
- Në nenin 30 bëhen ndryshime në nenin 85, që lidhen me Komisionin Shtetëror të PMV-ve, i cili merr kompetencën e regjistrimit të PMV-ve që kanë certifikatë tregtimi dhe tregtohen në një nga vendet e BE-së dhe të PMV-të të pajisura me certifikatë tregtimi nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave (EMA). Kryetari i Komisionit Shtetëror të PMV-ve nënshkruan certifikatën e tregtimit për secilin produkt të miratuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve ditë pune, pas pagesës nga kërkuuesi të tarifës së përcaktuar për regjistrim.
- Në nenin 31 propozohet të bëhen ndryshime në nenin 86, ku përcaktohet se asnjë produkt mjekësor veterinar nuk lejohet të tregtohet pa certifikatë tregtimi, me përjashtim të rasteve kur përdoret për qëllime të provave klinike të PMV-ve.
- Në nenin 32 propozohet ndryshimi i pikës 1, të nenit 87, duke shkurtuar si afat për miratimin nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve nga 210 ditë, që ishte, në 100 ditë. Kjo, me qëllimin që të përshpejtohen procedurat në ndihmë të subjekteve që kërkojnë të regjistrojnë dhe tregtojnë PMV në Republikën e Shqipërisë.
- Në nenin 33 bëhen ndryshime në nenin 88, ku përcaktohet se Komisioni Shtetëror ngrihet me propozimin e SPV-së dhe ka në përbërje dy përfaqësues nga SPV-ja; dy përfaqësues nga instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë dhe një përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës.
- Në nenin 34 propozohet ndryshime në nenin 102, duke përcaktuar SPV-në që të marrë masa për ngritjen dhe administrimin e një sistemi të farmako-

vigjilencës, ndërsa vetë SPV-ja merr masa për të siguruar njoftimin e reaksioneve të kundërta në kafshë, të dyshuara se ndodhin nga përdorimi. Në pikën 3, të shtuar, përcaktohet se autoriteti kompetent është institucioni që siguron shkëmbimin e informacionit nga sistemi i farmako-vigjilencës, që lidhet me PMV-të, të cilat janë lejuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë. Pika 4 përcakton se gjatë vlerësimit të të dhënave nga farmako-vigjilenca, kur struktura përgjegjëse për veterinarinë në ministri konsideron se një certifikatë tregtimi e PMV-ve duhet tërhequr, përfunduar ose ndryshuar, njofton menjëherë mbajtësin e certifikatës së tregtimit të PMV-ve, dhe KSHRV-në, i cili mund të vendosë me vendim të ndërmjetëm pezullimin e certifikatës deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Agjencia Evropiane e Medikamenteve njoftohet për vendimin e ndërmjetëm për pezullimin e certifikatës ose vendimin përfundimtar për heqjen e licencës. Ndërsa pika 5 përcakton se në rast të një nevojë të menjëhershme për ruajtjen e shëndetit të njeriut ose të kafshëve, KSHRV-ja, me propozim të strukturës përgjegjëse për veterinarinë në ministri ose autoritetit kompetent, mund të shfuqizojë certifikatën e tregtimit të PMV-ve. Në këtë rast, struktura përgjegjëse për veterinarinë njofton autoritetet e shëndetit publik, Agjencinë Evropiane të Medikamenteve dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, me të cilët Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe, si dhe palët e interesuara, jo më vonë se 1 ditë pune, pas vendimit të shfuqizimit. Ministri përcakton kushtet dhe procedurat për mbledhjen, përmbajtjen dhe dërgimin e informacioneve. Me këtë ndryshim, edhe autoriteti kompetent, në vendimmarrjen e tij bazohet në karakteristikat dhe profilin e sëmundjes; përhapjen e sëmundjes në Shqipëri dhe në vendet fqinje, nga ka ardhur sëmundja; disponueshmërinë, efikasitetin dhe rreziqet që paraqesin këto PMV në mirëqenien e kafshëve; disponueshmërinë e testeve diagnostikuese për të zbuluar infeksionet te kafshët; pasojat ekonomike, sociale, dhe ndikimin mjedisor, që sjell përdorimi i këtyre PMV-ve, në krahasim me strategjitë e tjera për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve. Pika 8 përcakton rregullat që miratohen me urdhër të ministrit. Autoriteti kompetent merr masat e duhura për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik, në lidhje me përdorimin e PMV-ve për studime shkencore ose për qëllime të zhvillimit të testimit të tyre në kushte të kontrolluara.

- Në nenin 35 propozohen ndryshime në nenin 105 të ligjit duke ndryshuar në titull fjalën “Zbatim” me “Ushtrim” pasi në këtë nen sanksionohen se cilët persona mund të ushtrojnë praktikën mjekësore veterinarë.
- Në nenin 36 propozohet ndryshimi i pikës 1, të nenit 106, nëpërmjet të cilit cilësohet se veprimtaritë veterinarë mund të kryhen edhe nga veterinerët zyrtarë, persona fizikë, që kryejnë praktikën mjekësore veterinarë (mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë, teknikët veterinarë (me arsim parauniversitar), teknikët e ndërzimit (inseminatorët), laboratorët veterinarë, feramat blegtorale, parqet dhe kopshtet zoologjike e të tjera.

- Në nenin 37 propozohet që në nenin 108 fjalët "... praktikës mjekësore veterinare ..." të ndryshohen në "... profesionit të mjekut veteriner ..." pasi në këtë nen bëhet fjalë se cilët persona mund të ushtrojnë profesionin e mjekut veteriner.
- Në nenin 38 propozohet që në nenin 109, të ligjit, të bëhen ndryshimet në pikën 1, e cila riformulohet. Gjithashtu, bëhet edhe një riformulim në pikën 2.
- Në nenin 39 propozohet që në nenin 112, të ligjit, të shtohen fjalët "... të miratuar me urdhër të Ministrit ..." për të mundësuar që ministri të mund të miratojë rregulloren për teknikët e ndërzimit.
- Në nenin 40 propozohet ndryshimi i nenit 114, të ligjit, duke shuar një pikë, ku përcaktohet kompetenca e ministrit për të miratuar rregulloren për funksionimin e klinikave dhe spitaleve veterinare. Aktualisht nuk ka një rregullore për funksionimin e tyre, sepse mungonte baza ligjore për miratimin e saj.
- Në nenin 41 propozohet ndryshimi i nenit 116, që, në raste emergjente dhe nevojash, ministri urdhëron kontraktimin e veterinerëve privatë.
- Në nenin 42 vendoset shfuqizimi i nenit 117, "Kontrata për delegimin e veprimtarive" pasi ky kontraktim do të kryhet vetëm në raste emergjente dhe krize dhe në bazë të legjislacionit përkatës për këto lloj kontratash.
- Në nenin 43 bëhen ndryshime në nenin 122, ku bëhet një zëvendësim dhe përcaktohet se laboratorët, objektet dhe personat e tjerë fizikë ose juridikë, të cilët përdorin agjentë patogjenë me qëllim kërkimin shkencor, edukimin, diagnostikimin ose prodhimin e vaksinave apo të produkteve të tjera biologjike, përveçse të bazohen në standardet ndërkombëtare përkatëse, duhet të marrin masat në lidhje me biosigurinë dhe izolimin biologjik, me qëllim ndalimin e përhapjes së agjentëve patogjenë dhe kontaktin e tyre me kafshët jashtë laboratorëve ose objekteve të tjera, ku këta agjentë përdoren, kujdesen që lëvizja e këtyre agjentëve patogjenë, vaksinave dhe produkteve të tjera biologjike nga laboratorët dhe objektet e tjera të mos shkaktojë rreziqe përhapjeje të sëmundjeve.
- Në nenin 44 propozohen ndryshime në pikën 1, të nenit 123, ku instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë do të jetë Qendër Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare, në të cilin do të kryhen vlerësime shkencore dhe do të jetë pjesë e rrjetit të shërbimit veterinar kombëtar. Kjo dispozitë përcakton se me vendim të Këshillit të Ministrave vendoset organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni.
- Në nenin 45 propozohen ndryshime në nenin 127, të ligjit, duke përcaktuar se shërbimi veterinar ka varësi vertikale, për të qartësuar mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit veterinar dhe përcaktuar se shërbimi veterinar drejtohet nga autoriteti kompetent i përcaktuar në këtë ligj dhe mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Në nenin 46 propozohet ndryshimi i nenit 128, të ligjit, ku përcaktohet se shërbimi veterinar kombëtar përbëhet nga struktura përgjegjëse për

veterinarinë, autoriteti kompetent, shërbimi veterinar rajonal dhe shërbimi veterinar privat. Gjithashtu, në këtë nen përcaktohet që organizimi dhe funksionimi i shërbimit veterinar rajonal përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Në nenin 47 përcaktohen ndryshime në nenin 129 dhe rregullohet e qartësohet kompetenca e SPV-së, e cila ka kompetenca politikëbërje dhe, konkretisht, harton politikat e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla; harton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinare, sipas përcaktimeve të këtij ligji; harton legjislacionin veterinar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke e përafruar e harmonizuar atë me legjislacionin e Bashkimit Evropian; harton programet e parandalimit, të kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të këtij ligji; harton modulet dhe përmbajtjen teknike të sistemit të identifikim regjistrimit të fermave dhe kafshëve; monitoron dhe harton raporte për vlerësimin e riskut dhe situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat që kryejnë veprimtari veterinare; informon institucionet shtetërore, strukturat e shëndetit publik, palët e interesuara në vend, OIE-në, BE-në dhe organizmat e tjera ndërkombëtare për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë; programon dhe planifikon buxhetin në fushën e mbrojtjes së shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbështetur në programet e kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për planifikimin e buxheteve; harton politika dhe strategji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve e fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi; monitoron veprimtarinë e autoritetit kompetent në lidhje me zbatimin e legjislacionit për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtarive të tjera veterinare.
- Në nenin 48 propozohen ndryshime në nenin 129 dhe shtohet neni 129/1, “Kompetencat e autoritetit kompetent”. Autoriteti kompetent ushtron kompetencat e mëposhtme: Drejton veprimtarinë e shërbimit veterinar në lidhje me kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtari të tjera veterinare, administron mjetet financiare për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbron shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, etj.
- Në nenin 49 propozohet riformulimi i nenit 130, të ligjit, duke e titulluar “Fusha e veprimtarisë së shërbimit veterinar shtetëror” dhe duke përcaktuar fushën e veprimtarisë së këtij shërbimi.
- Në nenin 50 propozohet ndryshimi i nenit 131, ku përcaktohen detyrat dhe veprimtaria e veterinarit zyrtar.
- Në nenin 51 propozohet të ndryshohet shkronja “a”, e pikës 1.3, të nenit 134.
- Në nenin 52 propozohet të shtohet neni 134/1, në lidhje me procedurat e kundravajtjeve administrative.

- Në nenin 53 propozohet të ndryshohet neni 135, që lidhet me shqyrtimin e ankimit të masave administrative.
- Në nenin 54 propozohet të ndryshohet neni 137, referuar licencimit, anulimit dhe revokimit të veprimtarive. Veprimtaritë e kryera për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake, që parashikohen në këtë ligj, licencohen dhe anulohen e revokohen sipas kategorive e nënkategorive respektive të fushës II, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Veterineri zyrtar, në rast se gjatë kontrollit vëren se nuk plotësohen kërkesat e këtij ligji ose konstaton se pas ndëshkimit për shkeljet e përcaktuara në nenet 15, 29, 30, 51, 83, 92, 94 e 96 nuk janë marrë masat korrigjuese brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e inspektimit, i dërgon menjëherë organit që ka dhënë lejen propozimin për marrjen e masave me vendime të ndërmjetme për pezullimin e licencës dhe/ose vendime përfundimtare për revokimin ose anulimin e licencës.
- Në nenin 55 është përcaktuar hyrja në fuqi, 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, ka përgatitur këtë projektligj.

Ky projektligji është bashkërenduar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Departamentin e Administratës Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj i është nënshtruar procesit të konsultimit publik dhe në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është publikuar në regjistrin elektronik ku nuk ka ardhur asnjë koment apo sugjerim. Gjithashtu, në datën 16.11.2018 është zhvilluar një takim konsultativ me grupet e interesit. Të pranishëm kanë qenë përfaqësues nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, klinika veterinare, farmacistë veterinarë, fermerë, veterinerë zyrtarë dhe privatë.

Miratimi i ndryshimeve ligjore të sipërpërmendura ka kosto financiare.

Për 170 veterinerë zyrtarë, nga 400 të nevojshëm, të cilët do të kryejnë shërbimet, fondi i nevojshëm do të përballohet nga fondi për veterinarin, i cili, aktualisht, përdoret për punën veterinare për kryerjen e masave profilaktike nëpërmjet shërbimit veterinar privat. Pra, do të mbulohet nga fondet që aktualisht janë pjesë e buxhetit të programuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht 130 milionë lekë.

Pjesa tjetër, për 230 veterinerë zyrtarë të njësive të reja, prej 176 milionë lekësh, do të rishpërndahet në PBA 2020 – 2022, duke vendosur proritete të reja në politikat dhe produktet e programit buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”.

Nga pushteti vendor do të merren funksionet, të cilat do t’i transferohen Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe në kuadër të kësaj politike të re, efektet shtesë të llogaritura do të mbulohen nga buxheti i MBZHR-së, brenda tavaneve buxhetore të PBA 2020-2022.

Ministria do të përdorë fondet e akorduara brenda tavaneve buxhetore të saj për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Artikulli	Numri	Kosto/person/vit	Vlera (ALL)	Mbulimi shpenzimeve
1	Veterinerë zyrtarë të njësive shtesë	230	768 000	176 640 000	MBZHR
2	Veterinerë zyrtarë me fondet tona	170	768 000	130 560 000	MBZHR
3	Investime fillestare (bërë një herë)	400	122 000	48 800 000	MBZHR
4	Shpenzime vjetore	61	45 000	2 745 000	MBZHR
T O T A L I (ALL)			1 703 000	358 745 000	

KËSHILLI I MINISTRAVE